

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetar, Fillim Skoro e Have Haliti, anëtar, me bashkëpunëtoreshen profesionale Syzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në lëndën penale të pandehurit K.P., nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet ushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individuale jashtë territorit të Republikës së Kosovës, nga neni 3, par.4 lidhur me par.3 të Ligjit, nr.05/L-002, për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit, duke vendosur përkritazi me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.9/2018, të dt.30.01.2018, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt.03.04.2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

I.Me aprovimin e ankesës të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.9/2018, të dt.30.01.2018, lidhur me vendimin mbi dënimin dhe të pandehurit K.P., për veprën penale më afër të përshkruar si në dispozitivin e aktgjyqimit ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.20.12.2017 deri me dt.30.01.2018.

II.Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR Prishtinë, PKR.nr.9/2018, të dt.30.01.2018, i pandehuri K.P., është shpallur fajtor për veprën penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet ushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individuale jashtë territorit të Republikës së Kosovës, nga neni 3, par.4 lidhur me par.3 të Ligjit, nr.05/L-002, për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit, dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.20.12.2017 deri me dt.30.01.2018.

Konformë nenit 48 të KPRK, me pëlqimin e të pandehurit K.P., dënimi me burgim i zëvendësohet në urdhër për punë në dobi të përgjithshme për periudhën prej 200(dyqind)orë pune, e cila duhet të kryhet brenda periudhës kohore prej 6(gjashtë)muajve, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Shërbimi Sprovues i Kosovës, vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave duhet të kryhet puna dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

Nëse i pandehuri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht këtë punë, gjykata urdhëron dënimin me burgim.

Është obliguar i pandehuri që ë paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas listës së shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50(pesëdhjetë)Euro, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesë:

-Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovon ankesën si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të pandehurit K.P., ti shqiptojë dënim burgu më të lartë efektiv.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.90/2018, të dt.02.03.2018, duke u sqaruar përkitazi në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e PSRK-së, dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të pandehurit ti shqiptohet një dënim më i lartë me burg efektiv, se sa me aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit në pajtim me nenin 390 par.1 të KPP, caktoi seancën e kolegjit ku morën pjesë i pandehuri K.P. si dhe mbrojtësja e tij av.S.K., ndërsa në seancë nuk prezantoi Prokuroi i Apelit edhe pse është njoftuar në mënyrë të rregullt dhe seanca është mbajtur në mungesë të tij, për arsye se pjesëmarrja e tij nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, edhe sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, e duke marrë parasysh edhe sqarimin me shkrim të Prokurorit të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, e pas shqyrtimit dhe vlerësimit edhe shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e PRSK, është e bazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, në ankesën e saj lidhur me vendimin mbi dënimin, pretendon se dënimi i shqiptuar në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve, i cili me pëlqimin e të pandehurit K.P., në pajtim me dispozitën e nenit 48, është zëvendësuar me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme në kohëzgjatje prej 200 orë pune, është në disproportcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës, peshën e veprës penale, si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, edhe përkundër asaj se i njëjti ka pranuar fajësinë dhe ka pasur sjellje korrekte në shqyrtimin fillestar, mirëpo, gjykata nuk ka vlerësuar rrethanat rënduese se veprat

penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtri, ose policinë e huaj, informacionet paraushtarake ose para policore, për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, dënimi është paraparë prej 6(gjashtë)muajve deri në 5(pesë)vite dhe nuk ekziston asnjë bazë ligjore që mund të justifikoj që dënimi prej 6(gjashtë)muajve, i shqiptuar ti shqiptohet dënimi alternativ urdhri për punë në dobi të përgjithshme për periudhën prej 200(dyqind)orë pune, e cila duhet të kryhet brenda periudhës kohore prej 6(gjashtë)muajve, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e PRSK, e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e saj.

Gjykata e Apelit vlerësoj pretendimet ankimor të paraqitura në ankesën e PRSK, dhe vlerësoi se ankesa është e bazuar, kjo për arsye se të pandehurit i është shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve, dhe gjykata drejtë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar dhe është penduar, e cila potencohet edhe në ankesën e PRSK, mirëpo, Gjykata e Apelit, dënimi me urdhër në dobi të përgjithshme i cili me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve, është zëvendësuar në kundërshtim me nenin 50 të KPRK, kjo për faktin se dënimet alternative përfshirë edhe dënimin me urdhër në dobi të përgjithshme shqiptohet për vepra të lehta penale dhe kur vlerësohet se edhe me dënimin e shqiptuar alternativ, mund të ndalohet kryesi nga kryerja e veprave penale tjera.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, e duke u nisur nga rregullat e përgjithshme mbi matjen e dënimit, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, motivin e kryerjes së veprës penale, sigurinë kombëtare të Republikës së Kosovës, si dhe duke vlerësuar se këto vepra penale intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur është në nivel të lartë kjo për arsye se një pjesë e rinisë është duke marrë pjesë në luftërat jashtë territorit të Republikës së Kosovës, e që është në kundërshtim edhe me dispozitat përkatëse ligjore, ky dënim i shqiptuar me burgim i cili është zëvendësuar me dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme për periudhën prej 200(dyqind)orë pune, nuk është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale, e sidomos duke pasur rrethanat të cilat aktualisht mbretërojnë në Kosovë, lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve në luftërat e huaja dhe si pasojë e mos vlerësimit të këtyre rrethanave nga ana e gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit, e ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me vendimin mbi dënimin dhe të pandehurit ia shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.20.12.2017 deri me dt.30.01.2018 dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dënimi i këtitillë i shqiptuar në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muaj, do ti shërbej preventives individuale që i pandehuri në të ardhmen mos të përsëris vepra penale të këtitilla apo tjera, si dhe preventivës së përgjithshme që dënimi i këtitillë të ndikoj edhe tek të tjerët në parandalimin e kryerjes së këtyre veprave penale, dhe pritet në tersi të arrihet edhe qëllimi i dënimit të paraparë si në nenin 41 të KPRK .

Si u cek edhe më lartë, me aprovimin e ankesës të PRSK, u deshtë të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e në bazë të nenit 403 par.1 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.89/2018, me dt.03.04.2018

Procesmbajtëse,

Suzana Goxhuli

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetare e Kolegjit,

Tonka Berishaj